# DËSHMI ARKIVI

**A-464283**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Zelensky në OKB: Putin, faktori që pengon përfundimin e luftës në Ukrainë! – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/zelensky-ne-okb-putin-faktori-qe-pengon-perfundimin-e-luftes-ne-ukraine/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 20:42:26 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 23 shtator 2026, 20:30:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `5ae26cc8d1c2da409b08bbaf708b1a023ce3d71ace8e176038e69f4f2871f1a4` |
| TEKSTI | `49bc49595dd2e432da842d1d86ca36d44cfd6a79867bdedc2a43148608343166` |
| PAMJA | `467c5484ce3f021568b1a859531f4e7a45173ca00cba21fd4c78a976270680e7` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `4997fb8de64b1c9d38a00be40a33668c302713032250d57fb95e8c960ab52e8b` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `55f810520a93a3fb0649992dafdc0630325acd6490d1af12697ee3ba7602edf3` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/4997fb8de64b1c9d38a00be40a33668c302713032250d57fb95e8c960ab52e8b`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Zelensky e nisi fjalimin e tij duke iu referuar humbjeve të ushtrisë ruse, por më pas e përqendroi kritikën e tij te lideri rus.

Duke folur për Putinin, presidenti ukrainas tha se “diçka e pengon gjithmonë të pranojë se 17 milionë kilometra katrorë të territorit të tij, të njohura ndërkombëtarisht nga të gjithë ju, duhet të jenë të mjaftueshme për këtë njeri”.

Ai theksoi gjithashtu se “Putini gjithmonë kërkon dikë që mund ta ndihmojë të vrasë më shumë njerëz, të pushtojë më shumë territore”.

REKLAMË

“Sa më shumë liri të ketë Putini për të vepruar, aq më i rrezikshëm bëhet bota për të gjithë të tjerët. Prandaj, ‘pacienti zero’ duhet të ndalet. Atij duhet t’i hiqet hapësira për të vepruar dhe hapësira për ta përhapur këtë të keqe”, deklaroi Zelensky.

Sipas tij, nga janari deri në gusht, ushtria ruse ka humbur 248.964 persona në fushëbetejën në Ukrainë.

“Ne kemi video që konfirmojnë secilën prej humbjeve ruse dhe këto nuk janë thjesht statistika”, tha lideri ukrainas, duke shtuar: “Është çmenduri, e megjithatë ata vazhdojnë të shkojnë atje për të vdekur, sepse kështu dëshiron Putini”.

Zelensky tha se, pavarësisht humbjes së një numri kaq të madh njerëzish, Rusia ka arritur këtë vit të pushtojë pak më shumë se 1 mijë kilometra katrorë të territorit ukrainas.

5 Ndryshime në drejtimin e Policisë së Shtetit, emërime të reja në disa qarqe

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

emaili juaj

Abonohu

REKLAMË

katrore të territorit ukrainas.

“Dhe ne tashmë kemi çliruar një pjesë të konsiderueshme të tij”, shtoi ai.

Presidenti ukrainas iu referua edhe ndihmës së Koresë së Veriut për Rusinë.

“Partneri i Putinit, lideri i Koresë së Veriut, dërgoi trupat e tij në Rusi për të forcuar pikat e dobëta të ushtrisë ruse. Edhe koreano-veriorët pësuan humbje. Ndoshta e patë transmetimin nga Pheniani, kur nderuan ata që humbën jetën. Dhe kjo është çmenduri”, tha Zelensky.

Duke folur për presidentin rus, Zelensky deklaroi se Putin kohët e fundit u ka premtuar sërish përfaqësuesve të presidentit amerikan se do të pushtojë rajonin e Donetskut dhe se i nevojiten edhe disa muaj.

“Kjo është ndoshta hera e 17-të ose e 18-të në pesë vjet që jep këtë premtim”, tha ai.

Zelensky vijoi duke deklaruar se Rusia ka pretendime edhe ndaj Moldavisë fqinje, ndërsa sipas tij, kërcënon vazhdimisht Poloninë dhe vendet baltike.

“Rusia nuk tregon asnjë respekt për shtetësinë e vendeve të Kaukazit Jugor dhe Azisë Qendrore. Dhe, fatkeqësisht, njerëzit në Siri dhe në të gjithë Afrikën e dinë shumë mirë se çfarë lloj vrasësish janë rusët”, përfundoi presidenti ukrainas.

#OKB #VizionPlus #Zelensky

WRITTEN BY
**Taulant Halili**
Gazetar/e · Vizion Plus

Të gjithë artikujt →

## Vazhdo të lexosh



BOTA

**SHBA: Rusia nuk ka asnjë plan lufte...**

Taulant Halili · 23 Sht 22:15



BOTA

**Bordi i Paqes propozon 2.45...**

Elisjeda Kiko · 23 Sht 21:51



BOTA

**Administrata Trump po përgatit një plan...**

Taulant Halili · 23 Sht 21:46

REKLAMË

## Lini një koment

Komenti juaj *

Me respekt — komentet moderohen nga redaksia.

Emri *

E-mail *

Nuk publikohet kurrë




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.